ne, por s' bâni dobii as t' bute as kertsnim pse tui kêne ghytéti i forte e shuitimi i mrênnshem me shumitse ushtriit e Turkut nuk u-trêmné kerkunn. Per gni muei rresht ngiati rréthimi, me ghith fare traximésh ci muité me sennerghue Skanderbégu per me lodhe t' mrênnshmit, e koha e vshtire e dimnit ishté tui u-atii ghytétit e paa se saa i vshtire ishté m' u-marre gni vênn ac i forte sidomos paa fare véglash e almitsash ci lypéshin per rrênim t' lédhévé e t' ghytétévé, kuur n' atò ménnimé i 'a mrriné edhè ullaket me fiale se Sulltan Murati kishté nise m' u-gaatue me ushtrii t' réia me msye Shcypniin. Me idhnim, i' u-desht m' u-shporre asì ghytétit e m:e 23 t' Tetorit massì pat lane pescinn luftare t' dékun m' at rréthim i 'u-desht m' u-drédhe n' Krue e m' u-gaatue per gni cinnrése mâa t' forte e mâa t' rrebte.

Fitimi i Sfétigradit n'lufte t' pare t' Sulltanit nuk ishté kêne ghaa facé t' saa gaatimévé ci kishté bàa per Shcypnii e ishté kêne gni marre m' u-drédhe me at fare fitimit, por ishté gni é bi érrun é forte per Skanderbégun e per Shcypnii, pse me at ghytét i ishté chile rruga anmikut kahe brégu i Drinit x.i paa muite kta me pase gni tiéter vênn fortsadiét per me i' u-bâa prite anmikut n' at âne, e ket pune e shifté mir-fillit Skanderbégu por tui hétue gaatimét e réia e paa se ishté marrii me ligshtue fuciit e pakta t' Shcypniis n' at vênn, e por saa kthéi n' Krue kerkoi me u-gaatue per cinnrése mâa t' mdhaa. Mâa s' parit fortsoi kryeghytétin e Shcypniis ku mlidhéi pshti-mi a fika e ghith Shcypni s, tui nnréce lédhé e soghé (1) per rreth per gni cinnrése t' forte, e Kruia u-bâa porsi gni chérdhé Shcypiét nnermiét t' shkrépavé nélte ku shpênn e bishe nuk munnen me mrriit. Miill e drithe e ghith fare shûitét ci lypéi per rrnése t' ushtarvé e t' ghith vénnasvé per gni motmot rresht kie gaatue me shumitse, e kiéné pertrii végla e almitsa luftaré cinnrését ci déri m' at hére kishin pase t' mangut tui lane mii ta ushtare Franchéx ci maa fort se tiére i a kishin doren e zéien.

Xani i Skanderbégut ci kishté marre hapte nnéper dhee kishte ngréhe n' Krue ghith fare koomésh tiéra, ci tui nnii trimniit e tiia e luftat e paa daame kishin lshue kush n' kerkim t' nneerimé-vé kush n' lakmii t' fitimit, e Iltì, Aléman, Shkiavon e Franchéx ghinnéshin me shumitse n' Krue t' lidhun me ushtrii Shcyptaré

---

(1) Soghé : bédéna, turcisht ; torri, italisht.